



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Datë, 22.08.2013

Nr. 0204-1122

PËR: Isa Mustafa, Kryetar i Komunës së Prishtinës
Sami Hamiti, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Prishtinës

LËNDA: KONFIRMIM I LIGJSHMËRISË SË VENDIMIT TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË PRISHTINËS, Nr.031-125588, të pranuar me datën 21.08.2013

Të nderuar,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në përputhje me mandatin e saj të përcaktuar me Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, shtojcën XII të Rregullores Qeveritare, Nr. 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, pas shqyrtimit të Vendimit Nr. 031 -125588, të miratuar me datë 23.07.2013 nga Kuvendi i Komunës së Prishtinës, **KONFIRMON** ligjshmërinë e aktit dhe vlerëson se i njëjti është në harmoni me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale.

Akti juridik i cili prodhon efekt të plotë juridik:

- Vendim Nr. 031 -125588, për ndalimin e ekspozimit të mallit jashtë lokaleve afariste dhe sipërfaqe publike.

Me respekt,

Slobodan Petrović,
Zëvendës Kryeministër & Ministër i MAPL,

Kopje: Besnik Osmani, Sekretari i Përgjithshëm në MAPL-së
Udhëheqësve të Departamenteve të MAPL-së
Arkivit të MAPL-së



Republika e Kosovës

Republika Kosovo-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Dana: 20.08.2013

Br. 0204 - 1122

Za : Isa Mustafa, Gradonačelnik Opštine Priština.
Sami Hamiti, Predsedavajući Skupštine Opštine Priština.

PREDMET: POTVRDA ZAKONITOSTI UREBE OPŠTINE PRIŠTINA
, Nr. 031-125588, Primljeno dana, 21.08.2013

Poštovani,

Ministarstvo administracije Lokalne samouprave, u skladu sa svojim mandatom određenim po Zakonu za lokalnu samoupravu Br. 03/L-040, dodatak XII Uredbe Vlade 02/2011 o poljima administrativne odgovornosti kabineta Premjera i Ministarstva, posle razmatranja Uredbe Br. 031-125588, usvojene dana 23.07.2013, od Skupštine Opštine Novo Priština **POTVRDJUJE** zakonitost ovog akta i ceni da je isti u skladu sa Zakonom Br.03/L- 040 za lokalnu samoupravu .

Pravni Akt niže neveden, ima puni pravni efekat.

- Odluka br. 031-125588 za zabranu izlaganja robe van poslovnih prostorija i javnih površina .

S poštovanjem,

Slobodan Petrović,
Zamanik premijera & Ministar MALS-a,

Kopija: Besnik Osmani, Generalni Sekretar MALS-a
Rukovodiocima Uprava MALS-a
Arhivu MALS-a.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina

Kjo gjëllim të mbrojtjes së konsumatorëve nga malli i ekspozuar jashtë lokaleve afariste dhe shitjes së tij në sipërfaqe publike, ku mund të ekspozohet kushieve të pafavorshme, siç janë: nxehtësia, frutet, insektet, pluhuri, gazrat e automjetet etj. Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në pajtim me dispozitat e nenit 12, paragrafi 12.2, pika d dhe nenit 17, pika i të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), dhe të dispozitave të nenit 34, paragrafi 34.1, pika d të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01 nr. 110 - 391, të datë 25.02.2010, më 23.07.2012, merr vend

VENDIM PËR

NDALIMIN E EKSPOZIMIT TË MALLIT JASHTË LOKALEVE AFARISTE DHE NË SIPËRFAQE PUBLIKE

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

TËRKUFIZIME

Neni 1.

Përkufizimet e mëposhtme kanë këto kuptime:

- a) "Ekspozimi i mallit", nënkupton mallin e ekspozuar para objekteve shitëse - qoshqeve, lokaleve afariste dhe në sipërfaqe publike: sheshe, rrugë, trotuare, plato, sipërfaqe të gjelbëruara dhe sipërfaqe të tjera publike;
- b) "Organizatë biznesi" nënkupton shoqërinë tregtare të regjistruar në Agjencinë e Regjistrimit të Biznesit në Kosovë, në përputhje me dispozitat e Ligjit për shoqëritë tregtare në fuqi;
- c) "Person juridik", nënkupton shoqëritë aksionare dhe shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar;
- d) "Person fizik", nënkupton biznesin individual: ndërmarrje, ortakëri, dyqan apo person privat;
- e) "Leje përkatëse" nënkupton lejen, të cilën në raste të caktuara e lëshon organi kompetent i Komunës së Prishtinës.

NDALIMI

Neni 2.

1. Organizatave të biznesit, të cekura në nenin 1 pikë b të këtij vendimi, iu ndaloher ekspozimi i mallrave jashtë objekteve afariste, artikujve ushqimorë dhe mjeteve të përdorimit të përgjithshëm, në qëllim të mbrojtjes së tyre nga ekspozimi në kushte të pafavorshme klimatike, siç janë: urrehtësia, ftohësia, insektet e ndryshme, pluhuri, gazrat e automjeteve të komunikacionit etj.

2. Personave fizikë, pa leje, të organeve kompetente të Komunës, iu ndaloher shitja e artikujve ushqimorë dhe mjeteve të përdorimit të përgjithshëm në sipërfaqe publike: sheshe, rrugë, trotuare, plato, sipërfaqe të gjelbëruara dhe sipërfaqe të tjera publike.

PËRJASHTIME

Neni 3.

1. Personat fizikë dhe personat juridikë me status të organizatës së biznesit, në raste të caktuara, mund t'i lejohet leja për ekspozim të mallit.

2. Lejen e vorante e lëshon organi kompetent i Komunës së Prishtinës, pas marrjes së pëlqimit mjedior dhe amvises për aksesin, të caktuar në rregulloren për taksa, tarifa dhe gjoha komunale.

MBIKËQYRJA

Neni 4.

Mbikëqyrjen do ta bëjë Inspekcioni komunal, Inspekcioni sanitar, Inspekcioni për mbrojtjen e mjedisit i Drejtorisë së Inspekcionit të Komunës së Prishtinës dhe Policia e Kosovës.

KONFISKIMI

Neni 5.

1. Ekspozimi i mallit para objekteve shitëse - lokalit afarist, qoshjeve, tregjeve dhe në sipërfaqe publike: sheshe, rrugë, trotuare, plato, sipërfaqe të gjelbëruara dhe sipërfaqe të tjera publike, si dhe shitja e druve, qymyrit, plehrave, gëlqeres dhe çdo lloj shitje tjetër ambulante pa leje të organit të cekura në nenin 1 dhe 3 të këtij vendimi, për pasojë ka konfiskimin e tij.

2. Malli i konfiskuar i kthehet personit fizik dhe personit juridik, pas pagesës së gjohes.

3. Malli i cili konfiskohet, qëndrueshmëria e të cilit është me afat të shkurtër, nëse nuk tërhiqet në afat prej 24 orëve, atëherë do të bëhet asgjësimi i tij. Asgjësimin e mallit do ta bëjë komisioni i caktuar nga Drejtoria e Drejtorisë së Inspekcionit.

4. Malli i cili konfiskohet, qëndrueshmëria e të cilit është me afat më të gjatë, nëse nuk tërhiqet në afat prej 30 ditësh, do t'i nënshtrohet shitjes së tij në bazë të dispozitave të ligjit në fuqi.

Gjohat mandatore

Neni 6.

1. Personi fizik do të gjobitet me gjobë prej 30 deri në 200 €, (gjobë mandatore), nëse bën vendosjen e objektit pa leje të organit kompetent:

- a) Panot dhe tabelat reklamuese (vendosja para lokaleve) deri 1m²: 30 €;
- b) Tavolinat para lokaleve: një tavolinë me 4 karrige: 50 €;
- c) Foltoret telefonike: 100 €;
- d) Mbishkrimet, firmat: 100 €;
- e) Paisjet për shitjen e akullorëve, nejkave, misrit, gështenjavë dhe të ngjashme: 100 €;
- f) Tavolinat lëvizëse për shitjen e luleve, bizhuterive, lojërave të faut e të ngjashme: 100 €;
- g) Automjetet lëvizëse për shitjen e ushqimit të shpejtë: 100 €;
- h) Tendat e hapura lëvizëse me mekanizëm: 100 €;
- i) Objektet tjera lëvizëse dhe statike që shfrytëzojnë hapësirën publike pa leje për qëllim përfitimi: 100 €;
- j) Bilbordet, shtillaciet, muralet (reklammat): 150 €;
- k) Ekranet elektronike reklamuese: 200 €;
- l) Posterët, fletushkat reklamuese, personi juridik gjobitet me 200 €;
- m) Tendat e hapura statike: 200 €;
- n) Drutë, thëngjill dhe gëlqerja deri në 3.5 tonelata: 100 €, mbi 3.5 tonelata: 200 €;
- o) Gjeneratorët statikë: 1 deri 15 kl: 50 €, mbi 15 kl: 200 €.

2. Pronari i biznesit individual do të gjobitet me gjobë prej 500 €, (gjobë mandatore), nëse vendosin objektin pa leje të organit kompetent:

- a) antenat satelitore dhe shpërndarëse: 500 € dhe
- b) lojërat sezonale në parqe: 500 €.

II. DISPOZITAT SHFUQIZUESE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 7.

1. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, pushon të vlejë Urdhëresa 01. nr. 031 - 1010, dt. 27.05.2010.
2. Ky vendim hyn në fuqi 8 ditë nga dita e publikimit të tij në tabelën e shpalljeve dhe ueb-faqen e Komunës së Prishtinës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS

01. nr. 031-125588, më 23.07.2013

KRYESUESI I KUVENDIT
Sami Hamiti, ecc. i dft.